



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 11/7 prot.

Tiranë, më 17.04.2018

VENDIM

Nr.34, datë 17.04.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 2, DATË 06.02.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 2, datë 06.02.2018 “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 11 prot., datë 10.01.2018”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet shkresës nr. 11 prot., datë 10.01.2018, punonjësja ***** me detyrë “Specialist” në Sektorin e Shërbimit Këshillimor, Drejtoria e Bujqësisë Tiranë, ka informuar Komisionerin se, me Urdhrin nr. 79, datë 18.12.2017, të Drejtorit të Bujqësisë Tiranë, është transferuar nga pozicioni “Specialist në Sektorin e Shërbimit Këshillimor” në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë në pozicionin “Specialist në Bashkinë Vorë (Qyteza Vorë)”, duke e konsideruar si të padrejtë. Për këtë arsye, Komisioneri ka filluar hetimin administrativ dhe ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 2, datë 06.02.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 11 prot., datë 10.01.2018”, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, që të rivendosë ligjshmërinë në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë:

- ✓ *Të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të Urdhrit nr. 79, datë 18.12.2017, për transferimin e punonjësës ***** nga pozicioni “Specialist në Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në pozicionin “Specialist në Bashkinë Vorë (Qyteza Vorë)”, në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë, pasi akti ka dalë në kapërcim të kompetencave ligjore të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, si dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji.*
 - ✓ *Të rregullohen pasojat e krijuara nga ky akt administrativ, në dëm të nëpunësit civil ***** , duke e rikthyer atë në pozicionin e mëparshëm të punës.*
2. *Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Bujqësisë Tiranë dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësja *****.*
 3. *Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, 10 ditë.*

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 2, datë 06.02.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës ***** , protokolluar me nr. 11 prot., datë 10.01.2018”, të Komisionerit, Drejtoria e Bujqësisë Tiranë, me shkresën nr. 145/1 prot., datë 13.02.2018, “Kthim përgjigje në lidhje me ankesën e *****”, ka informuar Komisionerin për zbatimin e këtij vendimi, duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, konstatoj se, me Urdhrin Nr. 7, datë 10.01.2018, “Për kryerje detyre”, titullari i institucionit, në zbatim të vendimit paralajmërues të Komisionerit, ka shfuqizuar Urdhrin e transferimit të kësaj nëpunëseje me nr. 79, datë 18.12.2017, duke e rikthyer atë në pozicionin që mbante përpara transferimit “Specialist në Sektorin e Shërbimit Këshillimor”. Për shkak të krijimit të vendit vakant në pozicionin “Specialist në Bashkinë Vorë (Qyteza Vorë)”, në Sektorin e Shërbimit Këshillimor në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë dhe ngarkesës së madhe të punës së këtij sektori, në pjesën urdhëruese të aktit të sipërcituar është përcaktuar gjithashtu se punonjësja ***** do të kryejë njëkohësisht edhe detyrën e Specialistit në Bashkinë Vorë, deri në plotësimin e tij në përputhje me ligjin.

Sa më sipër, konkludoj se nga ana e institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Tiranë, janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 2, datë 06.02.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës ***** , protokolluar me nr. 11 prot., datë 10.01.2018”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 2, datë 06.02.2018, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 11 prot., datë 10.01.2018”.*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar *(ish Drejtoria e Bujqësisë Tiranë aktualisht Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë)*, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr.2, datë 06.02.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha